



01 Nr. 592/25 Dt. 10.10.2025



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13, 17 pika k dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), nenit 1 paragrafi 2, nenit 3 paragrafi 2, neni 29 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 të Rregullores Komunale nr. 001-011-201, datë 03.01.2024, për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Transfereve dhe Granteve, neni 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për lejimin e mjeteve financiare

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, për lejimin e mjeteve financiare për subvencionimin (pagesën) e shpenzimeve të sistemit dhe banimit (strehimit) të Ali Manxhukit, (familje 9 anëtarësh nga komuniteti rom) nga Prizreni, rast social, kështu që, për këtë qëllim dhe në emër të sigurimit të strehimit të përkohshëm (banimit), lejohen mjetet financiare në shumën 370.00 € (treqind e shtatëdhjetë euro) për muaj në kohëzgjatje për një 1 (vit).
2. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës–pozicioni i subvencioneve dhe transfereve të Zyrës së Kryetarit të Komunës.
3. Obligohet Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria për Ekonomi dhe Financa për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Të lartcekurit,
 - Arkivës së Kryetarit.

